



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2022:103152

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05392841

P.nr. 192/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit A. S., për shkak të veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2023/22, të datës 20.05.2022, në seancën e hapur të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 28.02.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. A. S. nga P., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.02.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A. S., nga i ati A. dhe nëna V. e vajzërisë Q., i lindur më ... në P., ndërsa me vendbanim në Rr. “...”, P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar më parë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Pa autorizim ka poseduar substanca narkotike, ashtu që me datë 22.11.2021, rreth orës 19:50, ne rrugën “...”, në P., derisa një njësi policore ka ndaluar një veturë të tipit B... me ngjyrë të ... me targa ... në të cilën veturë ndodheshin katër persona D. U., G. G., E. M. dhe i pandehuri A. S., ku gjatë kontrollimit fizik nga ana e policisë, të pandehurit i janë gjetur dy pako të letrave të cilat shërbejnë për mbështjelljen e substancave narkotike, gjithashtu në derën e pasme të veturës ku ishte i ulur i pandehuri tek dera e pasme e veturës është gjetur një sasi e substancës narkotike me përbërje të jetë të llojit ..., ku pas ekzaminimit nga ana e Agjencisë së Forenzikës së Kosovës, ka rezultuar se substanca e dyshuar është ... me peshë të përgjithshme prej ... gram.

- me këtë ka kryer veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 367, 449 par. 2 nënpar. 2.6 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N M E D Ë N I M M E G J O B Ë

I. Ashtu që i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) Euro, të cilën i pandehuri detyrohet ta paguajë në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

II. Nëse i pandehuri refuzon ose nuk mund të paguaj gjobën në shumën e përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me gjobë do t ‘i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë do t ‘i llogaritet një (1) ditë burgim.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale/për paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej njëzet (20) Euro, në afatin prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr. 2023/22, të datës 20.05.2024 kundër të pandehurit A. S., për shkak të veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, me datë 28.02.2024 është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, në të cilën prokurori i shtetit para leximit të aktakuzës ka bërë rikualifikimin e veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, duke hequr par. 1 të të njëjtit nen andaj, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit dhe pasi gjykata bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtit i ofroj mundësinë e deklaramit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje, është penduar sinqerisht për veprimet e tij, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, nga gjykata ka kërkuar që t’i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimit të mjaftueshëm më mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë

shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i pandehuri, gjykata mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se duke vlerësuar provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës mbi bazën e të cilave është ngritur aktakuza, konsideron se pranimi i fajësisë nga i pandehuri ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore konform dispozitave të KPP-së, i propozon gjykatës që ta pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Mbrojtësi i të pandehurit av. A. S., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, duke shtuar se i njëjti ka qenë i ri në kohën e kryerjes së veprës penale dhe nuk i ka kuptuar pasojat e kësaj vepre, kërkoi nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh se i njëjti është i pa punë, mbajtës i familjes dhe i gjendjes së dobët ekonomike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, përbushen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur, pendimin për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, moshën e tij të re në kohën e kryerjes së veprës penale, gjendjen e dobët ekonomike, ndërsa si rrethana rënduese mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer penale, andaj mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar të pandehurit, është adekuat dhe në proporcion me shkallën e shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë me pëlqimin e të dënuarit është marrë në bazë të nenit 44 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së

Vendimi mbi detyrimin e kompensimit të shpenzimeve të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën-par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr. 192/22, dt. 29.02.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.